



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 25.01.2023
(Dokument parlamentar)

RAPORT

(Komision përgjegjës)

**PROJEKTLIGJI “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 55/2015
“PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR”**

I. HYRJE

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18.01.2022, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, e shqyrton bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Erion Braçe.

Për të prezantuar projektligjin në cilësinë e propozuesit, ishin present: Jorida Tabaku, Deputete.

Për të dhënë mendim mbi projektligjin në emër të Qeverisë, ishte present:

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Arvid Uruçi - Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

II. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

- Projektligji është propozim i një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutes së Shqipërisë, dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.
- Miratimi i këtij projektligji kërkon votimin pro nga shumica e deputetëve të pranishëm, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ligji nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", me gjithë qëllimin e tij të mirë, në praktike jo vetëm nuk ka rezultuar i suksesshem, por mjaft problematik në disa drejtime.

Ligji aktual paraqet problematika në raport me rregullimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, nenet 71 dhe 74 të së cilës sanksionojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit në të gjitha llojet e kontratave publike. Pikerisht, në momentin që ndodhet Shqipëria, pas hapjes së negociatave, aplikimi i një ligji që krijon problematika në raport me Marrëveshjen kuadër të Shqipërisë me vendet e Komunitetit Evropian, do të ishte mesazhi më i gabuar që iu dergohet shteteve anëtare. Prandaj, me qëllim dhënien fund njëherë e mirë të këtyre praktikave, projektligji i propozuar parashikon kufizimin e afatit të zbatueshmërisë së këtij ligji deri në datën 1 Janar 2023, sa i përket paraqitjes së kërkesave.

Duke qënë të vetëdijshëm që shqyrtimi i projektligjit mund të shkojë edhe përtej këtij afati, dispozita kalimtare sanksionon se të gjitha kërkesat që do të paraqiten pas këtij afati, do të refuzohen apriori nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIOA).

Miratimi i këtij projektligji do t'i mbyllte rrugë çdo përpjekje që kompani apo biznese të lidhura me nivelet e larta drejtuese të shtetit apo qeverisë, si dhe funksionarë të lartë që fshihen pas këtyre bizneseve të përfitojnë pasuri të çmuara shtetërore, duke u përjashtuar njëkohësisht nga detyrimet tatimore.

- ***Përmbërja e projektligjit:***

Projektligji perbehet nga 3 dispozita.

Neni 1 permban ndryshimin e afatit per paraqitjen e kerkesave per perfitimin e status it te investitorit strategjik, me nje afat maksimal deri ne daten 1 Janar 2023.

Neni 2 perben nje dispozite kalimtare, e cila percakton se te gjitha kerkesat e paraqitura pas dates 1 janar 2023, do te refuzohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve.

Neni 3 parashikon hyrjen ne fuqi te ligjit 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare, ne perputhje neni 83, pika 4 te Kushtetutes.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

V. INSTITUCIONET ZBATUES

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Fiancave si dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

VI. EFEKTET FINANCIARE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare per Buxhetin e Shtetit.

VII. DISKUTIMET NË KOMISION

Propozusi i projektligjit Znj. Tabaku bëri përshkrimin e projektligjit duke cituar se, ky projektligji është propozuar që afati për paraqitjen e kërkesave nga subjektet e interesuara të ndryshohet duke përcaktuar si afat datën 1 janar 2023 dhe për rrjedhojë, çdo projekt që do të paraqitet jashtë këtij afati të refuzohet apriori nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Miratimi i këtij Projektligji, i cili nuk parashikon asnjë efekt financiar për Buxhetin e Shtetit, do t'i mbyllte rrugë çdo përpjekje që kompani apo biznese të lidhura me nivelet e larta drejtuese të shtetit apo qeverisë, si dhe funksionarë të lartë që fshihen pas këtyre bizneseve të përfitojnë pasuri të cmuara shtetërore, duke u përjashtuar njëkohësisht nga detyrimet tatimore.

Në vijim znj. Tabaku u shpreh se në vitin 2015 u miratua ligji “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Në atë kohë, si deputete e parlamentit të Shqipërisë kam bërë disa amendamente, të cilat u rrëzuan, që lidheshin kryesisht me çështjen e pronës. Ligji konsideron si investim publik edhe disa investime strategjike të caktuara në disa fusha të caktuara, por edhe në një vlerë të caktuar, duke i hequr të drejtën pronarit legjitim të pronës për ta ushtruar të drejtën e tij të pronës dhe për të negociuar me palë të treta.

Pra, ndërhyrja shteti në mes dhe e shpronëson pronarin për qëllime të interesit publik, duke i konsideruar investimet strategjike si interes publik. Në gjykimin tim, në vitin 2015 kjo ishte e gabuar, ishte antikushtetuese. Nga viti 2015 ligji ishte parashikuar të zgjaste deri në vitin 2018, dhe që atëherë, më 31 dhjetor të vitit 2018, në nenin 36 përcaktohet afati i ligjit. Deri atëherë ligji është ndryshuar 4 herë. Të katra rastet për ndryshimin e ligjit kanë qenë raste ku është shtyrë vetëm afati i zbatimit të ligjit. Që kur u miratua ligji në vitin 2015, është thënë se ky ligj është një ligj tranzitor, sepse ndërkohë qeveria e Shqipërisë po planifikonte edhe një ligj tjetër për investimet.

Sot jemi në vitin 2023, kanë kaluar 8 vjet nga momenti i hartimit të këtij ligji, kanë kaluar të paktën 5 vjet nga momenti kur ky ligj duhej t’i kishte përfunduar efektet e tij, por qeveria shqiptare e ka shtyrë herë pas here, dhe sot duhet të kishim një ligj tjetër kuadër për investimet. Ligji i investimeve strategjike është keqpërdorur, ashtu siç kisha dyshim edhe në vitin 2015, dhe shtyrja në afatin kohor e po këtij ligji përsëri ka shërbyer, në gjykimin tim, për qëllime korruptive.

Ky ligj, kur është krijuar, është krijuar me idenë e disa fushave, që do t’i përcaktonte si sektorë strategjikë: energjetikën dhe mineraret, transportin, infrastrukturën, komunikimet elektronike dhe mbetjet urbane, turizmin, bujqësinë, fermën e madhe bujqësore, peshkimin, zonat e teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik, zonat me përparësi zhvillimi, por njëkohësisht edhe disa elemente të tjera që ligji i lë të hapura. Si përfundim, pas shumë shkresave, lufte dhe informacioni me qeverinë shqiptare për të marrë informacion për zbatimin e këtij ligji, kemi arritur të marrim një informacion se deri më sot janë marrë 36 vendime për investimet strategjike dhe nga këto 36 vendime 27 janë në fushën e turizmit. Këtu ka ndodhur edhe abuzimi më i madh me çështjen e pronave. Ka pasur 4 projekte në bujqësi, 2 projekte në energji. Në qoftë se keni një ligj për investimet strategjike dhe në situatën ku ndodhet sot Shqipëria, që ka pasur vetëm një burim deri pak vite më parë për energjinë, burimin hidrik, ligji mund të ishte shfrytëzuar për të parqe fotovoltaike apo për

çfarëdolloj projekti tjetër në energji apo për teknologji informacioni, për të cilën kemi 2 projekte, në industrinë automotivë kemi vetëm 1 projekt, në bujqësi 4 projekte dhe në energji 2 projekte. Pra, 27 investime strategjike janë në turizëm, ndër të cilat është edhe porti i Durrësit. Me justifikimin dhe abuzimin se është një investim strategjik, është përdorur një *fast-truck*, një procedurë e veçantë, një pjesë e tyre kanë ardhur në parlament.

Më tej z. Tabaku theksojë se përfundimi i këtij ligji është se në asnjë nga sektorët që thuhet se do të kishte zhvillim dhe investime strategjike nuk u realizua gjë, por u realizuan vetëm në fushën e turizmit, 27 projekte në turizëm, të cilat në pjesën më të madhe të tyre, të mos them në 95% të tyre, janë abuzive, nga persona me lidhje politike. Për këto arsye ne kemi kërkuar që ky ligj t'i ndalojë efektet e veta. Ky ligj nga 1 janari të mos pranojë më kërkesa të tjera për investime strategjike dhe parlamenti ta kufizojë qeverinë shqiptare në këtë proces që po ndodh me investimet strategjike, dhe ne të gjithë bashkë këtu, pse jo, të bëjmë një ligj tjetër për investimet strategjike, nëse është e paaftë qeveria ta bëjë, e cila ka thënë se do ta kishte gati në vitin 2018.

Relatori Z. Braçe, u shprehe kundër propozimin të znj. Tabakut për shtyrjen e afatit për subjektet e interesuar për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e vecantë” investitor strategjik për arsyen se ka disa tipologji të investitorit strategjik.

Z. Braçe u shpreh se ka disa rezerva në lidhje me këtë projektligj të cila janë, pika e parë, duhet garë, edhe për këtë, kur shteti vë në dispozicion tokë publike për një projekt zhvillimor turizmi apo çdo lloj gjëje tjetër, për më tepër kur anashkalohe disa kushte, siç janë kushtet e financimit. Kredi mund të marrim të gjithë në qoftë se kemi në dispozicion tokë. E dyta, në këtë rast, është zbatimi i kontratave. Po të marrim këto të katra të bujqësisë, që janë këtu, sepse janë të gjitha në Divjakë. Me përjashtim të njërit që ka bërë 90 hektarë me shegë, pjesa tjetër, më vjen keq, nuk kanë asnjë gjë atje në territor. E fundit, teknologjia ka ecur jashtë mase dhe këto instrumente duhen përdorur për ta modernizuar. Edhe te rasti i koncesioneve dhe të partneritetit publik-privat ne nuk mundet as të prokurojmë dhe as të lidhim kontrata për teknologji së cilës i ka kaluar koha. Sinqerisht, prokurimi publik, por edhe kontratat e partneritetit publik-privat janë instrumente që mund t'i përshtaten ndryshimit që po ndodh.

Pas pandemisë ndryshimet janë shumë të mëdha në qasjen ekonomike dhe teknologjike të ekonomisë dhe në nuk mund të vazhdojmë të prokurojmë dhe të marrim të njëjtat mallra dhe shërbime si në shekullin e shkuar. Domethënë janë disa instrumente shumë të mira, përmes garës, të cilat sjellin teknologji. Më vjen keq, por nuk ma mbush dot mendjen shtyrja apo afrimi i afatit, gjithmonë në qoftë se përdoret për mirë.

PËRFUNDIME:

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, mbështetur në argumentat e mësipërm të relatorit vendosi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm *mosmiratimin* në parim të këtij projektligji.

RELATOR

KRYETAR

Eduard SHALSI